



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 14.04.2025

Numër Protokolli: 2469/2025

A.nr.378/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.378/2025, të datës 28.02.2025, të parashtruar nga ankuesi S.M, kundër Vendimit me Nr.10-01-96 të datës 05.02.2025 të Komisionit për Ankesa nga Marrëdhënia e Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e filluar sipas ankesës me numër A.nr.378/2025, e datës 28.02.2025, të parashtruar nga ankuesi S.M.

A r s y e t i m

Ankuesi S.M (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 28.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1335/2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.10-01-96 të datës 05.02.2025 të Komisionit për Ankesa nga Marrëdhënia e Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, përmes të cilit akt i është refuzuar ankesa e datës 10.01.2023 lidhur me kompensimin material të diferencës së pagës për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në provat e lëndës dhe gjendje faktike, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës administrative, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës. Si rrjedhojë, i njëjti më datë 10.01.2025 ka parashtruar kërkesë

tek Komisioni i Ankesave nga Marrëdhënia e Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, lidhur me kërkesën për kompensimin e pagës shtesë me rastin e zëvendësimit të Zyrtarit të Pranimi për vitet 2021, 2022 dhe 2023, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me Nr.10-01-96 të datës 05.02.2025, i ka refuzuar kërkesën ankuesit.

Në kuptim të statusit të nëpunësve të Administratës Tatimore, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës; 1.2. anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; 1.3. zyrtarët/ët e Agjencisë së Aviacionit Civil dhe Agjencisë të Shërbimeve të Navigimit Ajror, që kryejnë shërbime operative në fushën e kontrollit dhe navigimit ajror; 1.4. anëtarët/ët e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike; 1.5. të punësuarat/it në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Agjenci të saj; 1.6. të punësuarat/it në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencitë e saj, përjashtimisht Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin Policor të Kosovës; 1.7. të punësuarat/it në Administratën Tatimore të Kosovës; 1.8. të punësuarat/it në Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin”, mirëpo Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka miratuar Ligjin Nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, i cili është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 12.01.2025, ndërsa sipas nenit 123 të këtij ligji, i njëjti hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës.*

Ligji Nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, ka për qëllim rregullimin e procedurave për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Kosovës që janë në fushëveprimin e Administratës Tatimore të Kosovës si dhe parimet e organizimit dhe të funksionimit të ATK, e ku sipas këtij ligji trajtohen edhe çështjet e marrëdhënies së punës të nëpunësve të Administratës Tatimore të Kosovës, rrjedhimisht punonjësit e Administratës Tatimore të Kosovës, të pakënaqur me vendimet e institucionit kanë të drejtë të inicojnë procedurën në gjykatën kompetente.

Në procedurë e sipër të shqyrtimit të rastit në fjalë, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Avokati i Popullit, më datë 25.07.2024, përmes kërkesës me numër protokolli KPD/538/2024, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 9 (paragrafët 5 dhe 7), nenit 14, nenit 16, nenit 26, nenit 79, paragrafi 4, nenit 89, paragrafi 12, të Ligjit nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, ku ndër të tjera në këtë kërkesë konkretisht në kreun IV pikën 18, 19, 20, 21 dhe 20 thekson se: *18. Avokati i Popullit konsideron se në rastin e Ligjit të kontestuar është përjashtuar krejtësisht mundësia e inicimit të procedurave në KPMSHCK, nga punonjësit e ATK-së. 19. Duke pasur parasysh përcaktimet e mësipërme të Ligjit për Zyrtarët Publikë (nenet 6 dhe 27) dhe të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të*

Kosovës (neni 2), Avokati i Popullit konsideron se përderisa punonjësit e ATK-së bëjnë pjesë në kategorinë e nëpunësve civilë me status të veçantë, ata u binden rregullave të përgjithshme për shërbimin civil. 20. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se paragrafi 12 i nenit 89 të Ligjit të kontestuar, i cili i udhëzon palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave që t'i drejtohen gjykatës kompetente, ua mohon punonjësve të ATK-së të drejtën për mjete juridike, përkatësisht shfrytëzimin e mjeteve juridike për inicimin e procedurës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. 21. Sipas këtij përcaktimi, Avokati i Popullit konsideron se punonjësit e ATK-së trajtohen ndryshe nga punonjësit e institucioneve të tjera, pa pasur ndonjë arsye të dukshme apo një qëllim legjitim të dukshëm, e që rrjedhimisht përcaktime të tilla bien ndesh edhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Megjithatë në këtë rast Avokati i Popullit është fokusuar vetëm te neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës. 22. Prandaj, marrë parasysh këtë që u theksua më sipër, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë nëse neni 89, paragrafi 12, i Ligjit të kontestuar është në pajtim me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], me nenin 45 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

Duke marr parasysh faktin se ankuesi është nëpunës i Administratës Tatimore të Kosovës, dhe lidhur me çështjet e kontestuara nga Avokati i Popullit sa i përket neneve të caktuara të Ligjit Nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, atëherë Kolegji i Këshillit, vlerëson se përderisa çështja është duke u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, plotësohen kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për pezullimin e procedurës administrative të rastit të ankuesit.

Kështu që theksuar si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.378/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit S.M;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.